



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr. 52
Prishtinë, më 25.1.2019, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Driton Çausi, Abdyl Salihu dhe Albulena Balaj-Halimaj.

Munguan: Arbërie Nagavci, Fidan Rekalju, Mufera Shinik, Verica Çeraniç dhe Nezir Çoçaj.

Të ftuar anëtarët e Këshillit Shtetëror të Cilësisë: Gazmend Luboteni-kryetar, Vjollca Krasniqi, Arta Jakupi, Xhavit Rexhaj, Rozafa Koliqi, Dukagjin Zekaj dhe Avni Gashi.

Përfaqësues tjerë: Rron Gjinovci/ORCA, Mërgim Gashi/KDI dhe përfaqësues të mediave.

Stafi mbështetës i komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Takim i komisionit me anëtarët e Këshillit Shtetëror të Cilësisë të AKA- së;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Takim i komisionit me anëtarët e Këshillit Shtetëror të Cilësisë të AKA-së

Ismajl Kurteshi, në fillim të takimit potencoi atë që e ka thënë në takimin e mbajtur me rektorët që KSHC është organ i pavarur dhe e respektojmë pavarësinë në marrjen e vendimeve, njëherit KSHC sikurse çdo organ tjetër në këtë vend vendimet e saj duhet të bazohen në ligj. Ky takim nuk ka për qëllim që të kërkojmë prej jush që t'i ndryshoni apo modifikoni qëndrimet e juaja, por ajo që kishim dashtë me dëgjuar është që ato vendime që ju i keni ndërmarrë të jenë në pajtueshmëri të plotë me ligjin, me procedurat, me kriteret me të cilat ju punoni. Po ashtu, detyrë e jona është që të kërkojmë nga ju edhe pse nuk kemi dëgjuar që ju keni refuzuar komunikimin me rektorët, por rektorët kanë deklaruar që nuk janë të interesuar të komunikojnë me ju dhe do që të shkojnë në grevë, dhe kërkesa jonë, si komision, është që ju të komunikoni sepse është detyrë e të gjithë zyrtarëve në këtë vend e të gjithë institucioneve që të komunikojnë ndërmjet vete, në rast të mos marrëveshjes t'i ballafaqoni faktet, në rast të mospajtimeve t'i drejtohen organeve të cilat merren me shqyrtimin e ankesave. Me këtë rast anëtarëve të KSHC-së iu dorëzoi dy pyetje me shkrim që i janë adresuar, njëra nga Kolegji Iliria dhe tjetra nga Departamenti i Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës.

Gazmend Luboteni, tha se KSHC është institucion i pavarur i emëruar nga Kuvendi i Kosovës. KSHC në mbledhjet e mbajtura më 15 dhe 16 janar 2018 ka shqyrtuar 104 programeve të studimit, 53 programe kanë qenë nga institucionet publike dhe 51 nga institucionet private të arsimit të lartë. Sipas udhëzimit administrativ 15/2018 kanë dështuar në përmbushjen e kriterëve 28 programe në institucione publike dhe 79 programe në institucionet private të arsimit të lartë. Arsyeja e refuzimit të këtyre programeve të studimit, qofshin ato të reja apo ato ekzistuese, ka qenë sepse të njëjtat nuk i kanë përmbushur kriteret që parashihen në udhëzimin administrativ. KSHC është e pavarur në vendimmarrje dhe punon e bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, përkundër faktit që një numër i madhe i programeve janë refuzuar për arsye se nuk i kanë përmbushur kriteret ligjore. Pretendimet e rektorëve se nuk kanë që të njoftuar me kohë nuk qëndrojnë, nga se KSHC konkretisht më 11 qershor 2018, iu është drejtuar të gjithë rektorëve të të gjitha institucioneve publike dhe private dhe është kërkuar nga rektorët që ta njëjtën ta nënshkruajnë duke deklaruar se e kanë të qartë përmbajtjen e saj. Institucionet e arsimit të lartë kryesisht kanë dështuar në përmbushjen e kriterëve minimale për sa i përket stafit të rregullt akademik andaj edhe ka ardhur deri te tërheqja e akreditimeve dhe nuk do të bëhet pezullimi i programeve sikurse është vepruar më parë. Anëtarët e KSHC-së përfshirë edhe 3 anëtarët ndërkombëtarë jemi të vendosur të zbatojmë legjislacionin në fuqi pa përjashtim.

Rozafa Koliqi theksoj se është dhimbshme që ne jemi duke diskutuar për kriteret minimale që të kemi një sistem arsimor më cilësor, ku kërkohet një profesor si bartës programi me 60 ECTS dhe vendimet e KSHC-së nuk kanë të bëjnë fare me politikë por janë vendime bazuar në fakte.

Xhavit Rexhaj tha se vendimet e marra nga KSHC nuk i dëmtojnë studentët, por përkundrazi me këto vendime ata do të ndjekin studime shumë më cilësore.

Vjollca Krasniqi tha se KSHC nuk ka për qëllim mbylljen e institucioneve, por ka për qëllim ngritjen e cilësisë në arsim përmes respektimit të kriterëve në mënyrë që studentët dhe profesorët të përfitojnë nga mobiliteti në vendet e Evropës.

Teuta Haxhiu, theksoi se propozimi i saj ka qenë takimi i përbashkët me rektorët dhe KSHC, duke respektuar pavarësinë në vendimmarrje të secilit. Tha se anëtarët e KSHC-së janë emëruar në Kuvend me bindjen se është bërë përzgjedhja më e mirë, mirëpo tha se nuk e kupton arsyen e refuzimit të saj në mbledhjet e KSHC-së në cilësinë e vëzhgueses. Tërheqësja e akreditimit për programet e akredituara tha se është e paqartë duke pasur parasysh se udhëzimit administrativ 15/2018, pika 1, e nenit 21, thuhet se institucioni duhet të paralajmërojë për vizitën dhe inspektimin e gjendjes së programeve të akredituara, ajo pyeti anëtarët e KSHC-së se në cilin vend keni shkuar të monitoroni një ligjërues në procesin e ligjërimit, si dhe KSHC a ka organizuar monitorim ndërkombëtar, siç parashihet në këtë udhëzim nëpërmjet të cilit parashihet në këto programe që ju ia keni hequr akreditimin, thjesht kur akreditohet një program a shkon KSHC të inspekton në institucionin përkatës.

Në vazhdim tha se është e paqartë që programet që kanë qenë të akredituara për një periudhë kohore iu është hequr akreditimi. Neni 16, pika 5 thotë: asnjë nga bartësit e arsimit të lartë privat nuk nxjerr mësimdhënës, ndërsa ju keni tërhequr akreditimin Fakultetit të Edukimit në Universitetin e Gjilanit, po ashtu edhe programin fillore në fakultetin e edukimit, dhe nga informacionet që i kemi ju dëshironi që të favorizoni institucionet private, kjo është e paligjshme dhe mbetet e paqartë se kush nxjerr mësimdhënës. Po ashtu përmendi tërheqjen e akreditimit të programit të gazetarisë në institucionet publike dhe akreditimin e një programi të tillë në institucione private, si dhe në Fakultetin Ekonomik, janë suspenduar një program i marketingut në tri nivele, bachelor, master dhe doktoratë, që sipas informatave që kam aty janë 6 profesorë me titull doktor të fushës së ngushtë të studimit. A janë konsultuar ekspertët e jashtëm për tërheqjen e akreditimit për këto programe apo thjesht një gjë të tillë e keni bërë nga zyrat?

Pastaj, i është tërhequr programi i infermierisë në Universitetin e Prishtinës, i vetmi në institucionet publike në Kosovë, ndërsa është akredituar në Universitetin e Gjilanit një program me një profesor jo të fushës, të një personi, pra, djalit të ish-deputetit Sabri Hamitit. Më tej përmendi se si është e rregulluar çështje e fushës së ngushtë të programeve në disa vende të Evropës, siç janë: Finlanda, Gjermani, Austri, Spanje, Lituani, Letoni etj. Për programet e reja që aplikojnë për akreditim kërkoni përmbushjen e kriterëve dhe mos bëni asnjë lëshim sa i përket fushës së përmbushjes së kriterëve.

Driton Çausi tha se atë që e ka parë në sistemin arsimor në periudhën e pasluftës, nuk njeh asnjë institucion që politika nuk ka ndërhy, e që kanë qenë të pavarura. Tha se beson që gjetjet e KSHC-së në këtë proces dhe heqja e akreditimeve janë të sakta. Ka informacione të shumta rreth gjendjes në institucione publike të arsimit të lartë në Kosovë, dhe e vlerëson të domosdoshme që të bëhet një hulumtim rreth themelimit të këtyre universiteteve, sidomos të këtyre të pas luftës. Hapja e universiteteve të reja e ka dëmtuar shumë Universitetin e Prishtinës, andaj nëse është e dëmshme mbyllja e këtyre institucioneve, po aq e dëmshme ishte vendimmarrja për hapjen e tyre, për arsye se asnjë nga këto institucione nuk është hapur me ndonjë plan, apo më mirë të themi me një platformë të përgjithshme për zhvillimin e sistemit të arsimit të lartë në Kosovë.

Lidhur me problemet e paraqitura me E-akreditimin për futjen e të dhënave të stafit akademik kërkoi sqarim nga anëtarët e KSHC-së lidhur me afatet e përcaktuara për këto të dhëna, si dhe kërkoi sqarim lidhur me çështjen e studentëve në programet në të cilat është tërhequr akreditimi.

Albulena Balaj-Halimi, tha se e gjithë çka do doja të thosha, e thanë kolegët, mirepo theksoi se deshiron të fliste për paqartësitë e vendimeve të atehershme dhe të tashme për programet që janë në riakreditim. Pyet që, a është bërë gabim kur janë akredituar atëherë, apo keni gabuar që ia keni tërhequr akreditimin pas procedurës së akreditimit dhe tha se dikush duhet të japë përgjigjësi për këto gabime, ose ju si Këshill ose bartësit e programit që është akredituar. Në vazhdim kërkoi mendimin e anëtarëve të KSHC-së lidhur me pretendimet e rektorëve se ministri ka bërë presion te KSHC për mbylljen e këtyre programeve duke mos akredituar apo tërhequr akreditimin. Nga takimi me reaktorët ata theksuan joseriozitetin e punës së Këshillit, dhe një nga ata ishte në komisionin e përzgjedhjes së juve si Këshill, pra tash a duhet të besojmë në seriozitetin e juaj apo në seriozitetin e atij që ka qenë në përzgjedhjen e juaj.

Valentina Bunjaku-Rexhepi, në diskutimin e saj, tha se hapja e universiteteve publike ka qenë politike dhe kjo është e njohur tani më, por që tani nuk duhet lejuar mbylljen e tyre për arsye politike. Kërkoi sqarim lidhur me tërheqjen e akreditimit të disa programeve të Universitetit të Gjilanit të cilat programe kanë pasur akreditim deri në vitin 2020-2021, pasi që disa nga këto programe kanë ekzistuar që nga viti 1970 në kuadër të shkollës së lartë pedagogjike. Me përzgjedhjen e anëtarëve të KSHC-së është menduar për zgjidhjen e një problemi afatgjatë, dhe nuk beson që ky këshillë ka për qëllim mbylljen e universiteteve publike, kur kemi parasysh se në këtë universitet ndjekin studimet studentë nga Kosova Lindore, dhe konsideron si të dëmshme mbylljen e këtij universiteti.

Abdyl Salihu, kërkoi sqarim nga anëtarët e KSHC-së lidhur me udhëzimin administrativ 06/2018, neni 4, pika 4.1 në të cilin thuhet: më së shumti 3 anëtarë vendorë të KShC-së mund të kenë angazhim institucional në institucione të njëjta, pasi që në bazë të informacioneve që ka vetëm në një institucion janë 5 profesorë të UP- it që janë anëtarë KShC-së dhe pyet se a e keni ngritur këtë çështje te ministri që të zëvendësohen këta dy anëtarë ngase është e padrejtë që një institucion që të ketë 5 anëtarë dhe institucionet apo fakultetet tjerë të mos kenë asnjë anëtar.

Fidan Rekaliu, në diskutimin e tij, tha se vendimet e KSHC-së janë të pavarura dhe në rast të ndonjë lëshimi eventual ekziston e drejta e ankesës e cila duhet të ndiqet.

Gazmend Luboteni, lidhur me çështjet e ngritura nga anëtarët e komisionit, tha se gjatë vlerësimit të programeve kanë marrë për bazë kriteret që janë të përcaktuara për fushën e ngushtë të studimit sipas nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe 3 dhe sipas platformës ERASMUS. AKA ka të drejtë në çdo moment nëse konstaton se standardet nuk janë në përputhje, ta tërheq akreditimin. Sipas nenit 14 të Ligjit për Arsimin e lartë thuhet se: standardet në të cilat është bazuar akreditimi duhet të përmbushen në të gjithë periudhën e akreditimit, dhe në momentin që dështohet në këtë drejtim KSHC e tërheq akreditimin, andaj bartësit e programeve fushat e studimit nuk i kanë pasur adekuate, disa kanë lëvizur disa nuk i kanë përmbushë kriteret.

Dukagjini Zeka, lidhur me çështje e ngritur sa i përket bazës ligjore të emërimit të anëtarëve të KSHC-së, tha se janë konsultuar me zyrën ligjore dhe kjo nuk paraqet ndonjë konflikt. Sa i

përket tërheqjes së akreditimit të programeve tha se ka pasur shkelje të kriterëve mbi bazën e të cilave janë akredituar, rasti konkret në Universitetin e Gjilanit në programin fillor që ka 240 kredi që kërkon 4 bartës të programit, këta kanë lëvizura stafin nga niveli bacholer në atë master, pra i kanë shkelur kushtet e akreditimit dhe çfarë ndodh tash, programi master i plotëson kushtet dhe i tërhiqet akreditimit nivelit bacholer.

Vjollca Krasniqi u bëri thirrje anëtarëve të komisionit për një vizitë pune në AKA dhe për t'u njoftuar për së afërmi në detaje për punën dhe procesin e akreditimit.

Gazmend Luboteni, tha se lidhur me çështjet e ngritura sa i përket politizimit të KSHC-së, tha se procesi i përzgjedhjes ka qenë transparent dhe gjithëpërfshirës madje njëri nga rektorët ka qenë pjesë e panelit përzgjedhës, dhe ndikimet politike nuk qëndrojnë. Tha se është duke u hartuar ligji për agjencinë i cili do të ndikojë edhe më tej në pavarësinë e Agjencisë.

Ismajl Kurteshi, në përmbyllje të takimit, ftoi anëtarët e KSHC-së dhe rektorët e Universiteteve Publike të bashkëpunojnë me qëllim të tejkalimit të situatës së krijuar.

3. Të ndryshme

Në këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 14:40.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Ismajl Kurteshi